

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, përmes gjykatëses së vetme gjykuese, Luljete Shabani, me praktikantin Edona Selimi, në lëndën penale kundër të akuzuarit J.Rr., për shkak të veprës penale, **Lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 lidhur me nenparag. 1.4 të KPRK-së**, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1802/2016, të datës 17.10.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 10.05.2018, mori dhe në prezencë të palëve publikisht shpalli, ndërsa më datë 11.05.2018 përpiloi këtë:

## AKTGJYKIM

I akuzuari J.Rr., nga babai S. dhe nëna S., e lindur Sh., i lindur më datë ... ne ..., jeton ne fshatin ..., Komuna e ..., i pa martuar, student, i gjendjes se dobet ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës se Kosoves, i pa denuar me pare dhe nuk zhvillohet procedure tjetër penale ndaj tij.

## ËSHTË FAJTOR

Sepse, me datë 27.09.2016, rreth orës 00:30 min, ne fshatin ..., Komuna e ..., per shkak te nje konflikti verbal me G.A., i akuzuari J.Rr., i ka shkaktuar lendime trupore te demtuarit Xh.Z., ne ate menyre qe fillimisht fjaloset me G.A. dhe ne momentin kur i demtuari Xh.Z. ka nderhyre me qellim qe te njejtin t'i ndajë, i akuzuari te njejtin e godet me grusht ne fytyre sakesisht ne syrin e majt, me ç'rast i akuzuarit me veprimet e tij, te demtuarit i ka shkaktuar lendime te lehta trupore, i cili per shkak te natyres se lendimeve detyohet te kerkoje ndihme mjekesore ne Emergjencen e Spitalit Rajonal ne Gjilan,

-me çka ka kryer veprën penale, **Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 lidhur me nenparag. 1.4 te KPRK-së**, andaj, Gjykata, në bazë të dispozitave të neneve 7, 17, 21, 51, 73, 114 të KPRK-së dhe nenit 365, 453 dhe 463 të KPPRK-së, i shqipton në bazë të dispozitave të neneve 7,17,21,46,73,114,të KPRK-së, dhe nenit 365, dhe 453 të KPPRK-së.

## E GJYKON DËNIM ME KUSHT

Të akuzuarin J.Rr. me **Dënim Burgu** në kohëzgjatje prej **3 (tre) muajsh**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në kohën prej **1 (nje) viti**, nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën gjykata dënimin me kusht do ta revokojë.

Obligohet i akuzuari që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe **paushallin gjyqësor** në lartësi prej **20 (njëzet) €**, te gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar, **udhëzohet në kontest juridiko-civil**, për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

## **A r s y e t i m**

*Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur propozim akuzë PP.nr. 1802/2016, të datës 17.09.2016, kundër të akuzuarit J.Rr. nga fshati ..., Komuna e ..., për shkak të veprës penale, Lendim i lehte trupor nga neni 188 parag. 1 lidhur me nenparag. 1.4 të KPRK-së dhe ka kërkuar që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit.*

*Prokurorja e Prokurorisë Themelore në Gjilan Departamenti i Përgjithshëm, Rozelida Manastiri, në shqyrtimin gjyqësor e publik të mbatjur me dt. 10.05.2018, deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktit akuzues dhe konsideron se me pranimin e fajësisë në shqyrtimin e sotëm gjyqësor dhe provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, u vërtetua se i njëjti e ka kryer veprën penale që ia vë në barrë akti akuzues dhe se këtë e ka bërë me vetëdije të plotë, edhe pse është njoftuar lidhur me pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë. Andaj kërkoi nga Gjykata që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe ta dënoi sipas ligjit.*

*I akuzuari J.Rr., deklaroi se e pranoi fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë sipas aktit akuzues dhe shtoi se i vie keq për veprën e kryer dhe premtonte se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra tjera penale, andaj, kërkoi nga Gjykata që t'ia shqiptojë një dënim sa më të butë.*

*Gjykata analizoi provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe me vet pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit erdhi në përfundim se i akuzuari J.Rr. e ka kryer veprën penale, Lendim i lehte trupor nga neni 188 parag. 1 lidhur me nenparag. 1.4 të KPRK-së.*

*Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit Gjykata pati parasysh rrethanat të parapara me nenin 73 të KPRK-ës, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, pati sjellje të mira në Gjykatë, premtimi i tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, ndersa si rrethane renduese pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-ës.*

*Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPRK-së.*

*Nga të cekurat më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM  
P.nr. 1248/16, më datë 11.05.2018**

*Praktikantja  
Edona Selimi*

*Gjykatësja e vetme gjykuese,  
Luljete Shabani*

**KËSHILLA JURIDIKE:** *Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të së njëjtes. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplarë, përmes kësaj Gjykate.*